



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2020:113905

Datë: 08.05.2024

Numri i dokumentit: 05665885

C.nr.4613/23

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtarja Edije Sezairi, në kontestin e paditësit S.B. nga Prizreni, të cilin me autorizim e përfaqëson i autorizuari avokat A.Sh. nga Prizreni, kundër të paditurës P.K. Drejtoria e Përgjithshme e Policisë Prishtinë, të cilën e përfaqëson përfaqësuesi i Q.R.K. Avokatura Shtetërore avokatja shtetërore N.K. nga Prishtina, për shkak të anulimit të vendimit, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor, më datë **21.02.2024**, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET si e bazuar kërkesëpadia e paditësit S.B. nga Prizreni dhe **ANULOHEN si të kundërligjshëm**: vendimi nr.07/1-01A/7721 të datës 18.11.2016, efektiv nga data 21.11.2016 i të paditurës P.K., Drejtoria e Përgjithshme e P. Prishtinë për emërimin e paditësit në pozitën hetues i Ekipit B në Njësinë Rajonale për Hetimin e Krimeve Ekonomike dhe Korrupsionit në Prizren dhe vendimi nr.07/1-01A/7772 të datës 22.11.2016, efektiv nga data 23.11.2016 i të paditurës Policia e Kosovës, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë Prishtinë për emërimin e paditësit në pozitën hetues i Ekipit A në Njësinë Rajonale për Hetimin e Krimeve Ekonomike dhe Korrupsionit në Prizren.

II. DETYROHET e paditura P.K. Drejtoria e Përgjithshme e Policisë Prishtinë, që paditësin S.B. ta kthejë në punë dhe detyrat e punës së mbikëqyrësit të Ekipit A në Njësinë Rajonale për Hetimin e Krimeve Ekonomike dhe Korrupsionit në Prizren, sipas vendimit nr.07/1-01A/0422 të datës 20.01.2015, me të gjitha të drejtat nga marrëdhënia e punës, të gjitha këto brenda afatit 7 ditor nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit, nën kërcënim të përmbarimit me dhunë.

III. DETYROHET e paditura që në emër të shpenzimeve procedurale, t'ia paguaj paditësit shumën në lartësi prej 1,694 euro, të gjitha këto brenda afatit 7 ditor nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit, nën kërcënim të përmbarimit me dhunë.

A r s y e t i m

Pretendimet e palëve ndërgjyqëse

Paditësi S.B. nga Prizreni, përmes të autorizuarit të tij pranë kësaj gjykate ka parashtruar padi në të cilën ka theksuar se i njëjti me vendimin e Drejtorisë së Personelit të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë numër 07/1-01A/0422 të datës 20.01.2015, ishte i emëruar në pozitën e Mbikëqyrës të Ekipit A, në njësinë Rajonale për Hetimin e Krimeve Ekonomike dhe Korrupsion në Prizren. Sipas padisë, nga pozita e cekur më lartë, këtu paditësi

me vendimin e Drejtorisë së Personelit të Drejtorisë së Përgjithshme të P. numër 07/1-01A/7772 të datës 22.11.2016, ishte caktuar si hetues i Ekipit A, në Njësinë Rajonale për Hetim të Krimeve Ekonomike dhe Korrupsion në Prizren. Kundër këtij vendimi, paditësi kishte ushtruar ankesë përmes zinxhirit komandues dhe se Drejtoria e Personelit me përgjigjen numër 07/1-01/0185 të datës 13.12.2016 paditësi shtoi se në afatin ligjor ka ushtruar ankesë në përgjigjen e lartcekur dhe se nga Paneli i Komisionit për Ankesa me vendimin numër 001-KA-A-2017 të datës 25.01.2017, është refuzuar si pa bazuar ankesa e tij. Sipas padisë, gjatë marrjes së këtij vendim nuk është respektuar hierarkia e vendosjes në Policinë e Kosovës pasi që ndërimi i pozitës është bërë me propozim të personit jo kompetent dhe pa dijeninë e Shefit të Njësisë, siç e parasheh neni 35 par. 3 të Udhëzimit Administrativ numër 07/2012 i cila rregullon marrëdhënien e punës brenda policisë. Shkelje tjetër të cekur sipas paditësit është fakti se në vendimin me të cilin i është ndërruar pozita nuk përmban asnjë arsytim se ky ndryshim a ka të bëjë me sistemim e përkohshëm a të përhershëm, ku për ndryshimin e këtyllë janë paraparë kushtet ligjore të cilat duhet të plotësohen, që në rastin konkret nuk janë plotësuar.

Përfaqësuesja e palës së paditur, avokatja shtetërore N.K. në përgjigjen në padi ka theksuar se e paditura në tërësi e konteston kërkesëpadinë e paditësit, duke shtuar se vendimi i atakuar është marrë konform të gjitha dispozitave ligjore në fuqi dhe se pretendimet e palës paditëse për anulimin e tyre nuk janë të qëndrueshme. Andaj, gjykatës i ka propozuar që pas administrimit të provave, të refuzoj kërkesëpadinë e paditësit si të pa bazuar.

Lidhur me këtë çështje juridike kontestimore, kjo gjykatë ka marrë aktgjykimin C.nr. 1307/2020 të datës 26.03.2021, sipas të cilit në pikën nën I të këtij vendimi është aprovuar kërkesëpadia e paditësit SB. nga Prizreni, si e bazuar dhe janë anuluar si të kundërligjshëm vendimi nr.07/1-01A/7721 të datës 18.11.2016, efektiv nga data 21.11.2016 i të paditurës Policia e Kosovës, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë Prishtinë për emërimin e paditësit në pozitën hetues i Ekipit B në Njësinë Rajonale për Hetimin e Krimeve Ekonomike dhe Korrupsionit në Prizren dhe vendimi nr.07/1-01A/7772 të datës 22.11.2016, efektiv nga data 23.11.2016 i të paditurës Policia e Kosovës, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë Prishtinë për emërimin e paditësit në pozitën hetues i Ekipit A në Njësinë Rajonale për Hetimin e Krimeve Ekonomike dhe Korrupsionit në Prizren, në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi gjykata e ka detyruar të paditurën Policia e Kosovës, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë Prishtinë, që paditësin S. B. ta kthejë në punë dhe detyrat e punës së mbikëqyrësit të Ekipit A në Njësinë Rajonale për Hetimin e Krimeve Ekonomike dhe Korrupsionit në Prizren, sipas vendimit nr.07/1-01A/0422 të datës 20.01.2015, me të gjitha të drejtat nga marrëdhënia e punës, të gjitha këto brenda afatit 7 ditor nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit, nën kërcënim të përmbarimit me dhunë, ndërsa në pikën III të dispozitivit të këtij vendimi gjyqësor është detyruar e paditura që në emër të shpenzimeve procedurale t'ia paguaj paditësit shumën në lartësi prej 1,080,00 euro, të gjitha këto brenda afatit 7 ditor nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit, nën kërcënim të përmbarimit me dhunë.

Me aktvendimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr.8654/22 të datës 08.11.2023, është aprovuar si e themeltë ankesa e të paditurës Policia e Kosovës dhe është prishur aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prizren, C.nr. 1307/2020 të datës 26.03.2021 dhe lënda i është kthyer të njëjtës gjykatë në rishqyrtim dhe vendosje.

Duke vepruar sipas aktvendimit 8654/22 të datës 08.11.2023 të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Gjykata Themelore në Prizren ka caktuar dhe mbajtur shqyrtimin kryesor, në të cilin janë marrë parasysh vërejtjet e dhëna sipas aktvendimit të lartcekur.

Në shqyrtimin kryesor dhe në fjalën përfundimtare, i autorizuari i paditësit avokat A.Sh. ka ngelur pranë padisë, kërkesëpadisë dhe deklarimeve të bëra gjatë shqyrtimit kryesor, dhe propozojmë të aprovohet kërkesëpadia e paditësit në tërësi si e bazuar, po ashtu mbeten në tërësi konform aktvendimit të Gjykatës Supreme me Rev.nr.382/2022 të datës 22.11.2022, pasiqë paditësi në përpikëri dhe në mënyrë profesionale detyrat dhe përgjegjësit e tija janë në harmoni me nenin 30 të Rregullores për personel dhe administratë në policinë e Kosovës me veprimet e të pandehurit paditësi është diskriminuar në këtë rast edhe pse punën e bërë në mënyrë profesionale të mundshme në kuptim të dispozitës të nenit 26, 27 e lidhur me nenin 38 të Udhëzimit administrativ 01/2012 pa asnjë bazë ligjore apo ndonjë arsye ku edhe në këtë seancë nga e paditura kërkojmë arsyen për të cilën nuk është përgjigjur asnjëherë përveç dispozitave të Udhëzimit administrative e paditura bie ndesh edhe me dispozitën e nenit 2 e lidhur me nenin 23 të deklaratës universale për të drejtat e njeriut të miratuar nga asambleja e përgjithshme kombeve të bashkuar. Gjithashtu, në fjalën përfundimtare, i autorizuari i paditësit ka deklaruar se mbesin në tërësi pranë deklarimeve në seancat paraprake dhe kërkojnë nga gjykata që të anulohen vendimet e drejtorisë së personelit me numër 07/1-01A/7721 të datës 18.11.2016 dhe, vendimi 07/1-01A/7772 të datës 22.12.2016 si dhe vendimi me numër 001-KA-A-2017 të datës 25.01.2017 dhe të bëjë kthimin në vendin e punës në bazë ligjore, pasiqë ai vend është fituar në bazë të meritës dhe punës së bërë në mënyrë profesionale dhe se e paditura ka vepruar në kundërshtim me nenin 44 të Ligjit për Policinë e Kosovës dhe se procedura për ndërrim të pozitës nuk bëhet nga drejtoria e personelit të policisë, mirëpo vendimi përfundimtar bëhet nga drejtori i përgjithshëm i policisë. Andaj, gjykatës i ka propozuar që kërkesëpadinë e paditësit të aprovohet në tërësi si të bazuar të anulohen vendimet e goditura dhe të bëjë kthimin e paditësit në vendin e mëparshëm të punës, duke i kërkuar edhe shpenzimet procedurale.

Në seancat e shqyrtimit kryesor dhe në fjalën përfundimtare, e autorizuar e palës së paditur ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë kundërshtimeve të dhëna në përgjigjen në padi dhe ato të dhëna në shqyrtimin kryesor. E paditura, respektivisht komisioni i brendshëm disiplinor duke u bazuar në Ligjin për Policinë e Kosovës, paneli disiplinor pas mbajtjes së seancës dëgjimore S.B. është shpallur fajtor për shkak të shkeljes disiplinore, me ç'rast komisioni punonjësit në fjalë ia ka shqiptuar masën disiplinore ndalesë në pagë 25% e pagës mujore bruto për tre muaj si dhe masën plotësuese Transfer Administrativ. Ndaj këtij vendimi paditësi ka paraqitur ankesë e cila i është refuzuar si e pabazuar, pasiqë vendimi i atakuar është marrë konform dispozitave në fuqi dhe ajo që pretendon pala paditëse nuk qëndron fare, Andaj, gjykatës i ka propozuar që të refuzoj kërkesëpadinë e paditësit si të pa bazuar dhe të lë në fuqi vendimin kontestues si të ligjshëm. Shpenzimet procedurale nuk i ka kërkuar.

Provat e administruara dhe gjendja faktike e vërtetuar

Për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike gjykata ka administruar provat si në vijim: Vendimin me numrin e referencës 07/1-01A/0422 të datës 20.01.2015 lëshuar nga Ministria e Punëve të Brendshme – P.K. - Drejtoria e Përgjithshme e Policisë, Drejtoria e Personelit Prishtinë; Vendimin me numrin e referencës 07/1-01A/7772 të datës 22.11.2016 lëshuar nga Ministria e Punëve të Brendshme - Policia e Kosovës - Drejtoria e Përgjithshme e Policisë, Drejtoria e Personelit Prishtinë; Përshkrimin e vendimeve të marra nga sistemi Prims; Ankesën në lidhje me vendimin me nr. 07/1-01A/7772 të datës 22.11.2016, ankesa regjistruar tek paditura me numrin e referencës 06/1-2/1-PY/307/16 me datës 02.12.2016; Memorandumin zyrtar lëshuar më datë 13.12.2016 nga Ministria e Punëve të Brendshme – P.K. - Drejtoria e Përgjithshme e Policisë në Prishtinë me nr. të referencës 06/1- 02/PZ/306/16, lidhur me

përgjigje me numër të ref. 07/1-01/0185 të datës 13.12.2016; Ankesën në lidhje me përgjigjen numër 07/1-01-0185 të datës 13.12.2016, me nr. referencës tek e paditura 01/1-2-1-PZ-324/16 të datës 27.12.2016; Vendimin e Komisionit për Ankesa të Policisë së Kosovës, me nr. të lëndës 001-KA-A-2017 të datës 25.01.2017; Akt komunikimin në mes të paditësit dhe Drejtorit të Krimeve Ekonomike të datës 24.11.2016; Vendimin me numër të referencës 07/1-01A/7721 të datës 18.11.2016 lëshuar nga Ministria e Punëve të Brendshme Policia e Kosovës Drejtoria e Përgjithshme e Policisë, Drejtoria e Personelit Prishtinë; Memorandumin zyrtar të datës 07.11.2016 lëshuar nga e paditura; korrespondencën përmes rrugës elektronike të datës 17.11.2016 ora 14:43; korrespondencën përmes rrugës elektronike të datës 18.11.2016 ora 15:30; korrespondencën përmes rrugës elektronike të datës 18.11.2016 ora 3:21 PM; korrespondencën përmes rrugës elektronike të datës 18.11.2016 ora 3:11.

Gjykata pas vlerësimit të pohimeve të palëve ndërgjyqëse dhe provave të lartcekura, në kuptim të nenit 8 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), me kujdes dhe me ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha ato së bashku ka gjetur se:

Kërkesëpadia e paditësit është e bazuar.

Nga leximi i Vendimit me numrin e referencës 07/1-01A/0422 të datës 20.01.2015 lëshuar nga Ministria e Punëve të Brendshme - Policia e Kosovës - Drejtoria e Përgjithshme e Policisë, Drejtoria e Personelit Prishtinë, gjykata ka vërtetuar se paditësi S.B. është emëruar në pozitën mbikëqyrës i Ekipit A, në Njësinë për Hetimin e Krimeve Ekonomike dhe Korrupsionit në Prizren, në gradën rreshter.

Me leximin e Vendimit me numrin e referencës 07/1-01A/7772 të datës 22.11.2016 lëshuar nga Ministria e Punëve të Brendshme Policia e Kosovës Drejtoria e Përgjithshme e Policisë, Drejtoria e Personelit Prishtinë, gjykata vërtetoi se paditësi S.B. është emëruar në pozitën hetues i Ekipit A, në Njësinë për Hetimin e Krimeve Ekonomike dhe Korrupsionit në Prizren, në gradën rreshter.

Përmes leximit të Përshkrimit të vendimeve të marra nga sistemi Prims, gjykata ka vërtetuar se paditësi ka filluar detyrën në pozitën e hetuesit në Ekipin A në NJRHKEK në Prizren më datë 23.11.2016, nga data 21.11.2016 deri më 23.11.2016 ka qenë në pozitë të hetuesit në Ekipin B në NJRHKEK në Prizren, nga data 19.01.2015 deri më 21.11.2016 ka qenë në pozitën e mbikëqyrësit të Ekipit A në NJRHKEK në Prizren, nga data 15.11.2010 deri më 19.01.2015 ka qenë në pozitë të mbikëqyrësit në NJRHKEK në Prizren dhe nga data 28.01.2008 deri më 15.11.2010 ka qenë në pozitë të mbikëqyrësit në DRP në Prizren, Departamenti i Hetimeve.

Me leximin e Ankesës në lidhje me vendimin me nr. 07/1-01A/7772 të datës 22.11.2016, ankesa regjistruar tek paditura me numrin e referencës 06/1-2/1-PY/307/16 më datë 02.12.2016, gjykata vërtetoi se më datë 02.12.2016, paditësi ka parashtruar ankesë ndaj vendimit me nr. 07/1-01A/7772 të datës 22.11.2016, për shkak të pakënaqësisë, duke kërkuar përgjigje nga Drejtori i Drejtorisë së Personelit në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë.

Nga leximi i Memorandumit zyrtar lëshuar më datë 13.12.2016 nga Ministria e Punëve të Brendshme – P.K. - Drejtoria e Përgjithshme e Policisë në Prishtinë me nr. të referencës 06/1-02/PZ/306/16, lidhur me përgjigjen me numër të ref. 07/1-01/0185 të datës 13.12.2016, gjykata ka vërtetuar se Drejtori i Drejtorisë së Personelit në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë, F.A. është përgjigjur në ankesën e datës 02.12.2016, duke arsyetuar se vendimi nr. 07/

1-01A|7772 të datës 22.11.2016 është lëshuar në pajtim me udhëzimin administrativ 07/2012 dhe se nuk ka pasur ndonjë gabim teknik dhe ka udhëzuar që ka të drejtë në ankesë në Komisionin për Ankesa.

Prej leximit të Ankesës në lidhje me përgjigjen numër 07/1-01-0185 të datës 13.12.2016, me nr. referencës tek e paditura 01/1-2-1-PZ-324/16 të datës 27.12.2016, gjykata ka vërtetuar se paditësi ka parashtruar ankesë pranë Komisionit për Ankesa dhe Shpërblime të DPP-së më datë 27.12.2016, duke kërkuar që të shqyrtohet me kujdes ankesa e tij sa i përket vendimit nr. 07|1-01A|7772 të datës 22.11.2016.

Me leximin e Vendimit të Komisionit për Ankesa të Policisë së Kosovës, me nr. të lëndës 001-KA-A-2017 të datës 25.01.2017, gjykata vërtetoi se Komisioni për Ankesa i Policisë së Kosovës, ka refuzuar si të pabazuar ankesën e datës 27.12.2016, të parashtruar nga paditësi, duke udhëzuar paditësin që në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimin të vendimit, mund të inicioj procedurën gjyqësore pranë Gjykatës Themelore, të cilin vendim paditësi e kishte pranuar më datë 31.01.2017.

Nga leximi i Akt komunikimit në mes të paditësit dhe Drejtorit të Krimeve Ekonomike të datës 24.11.2016, gjykata vërtetoi se paditësi ka komunikuar në mënyrë elektronike me Drejtorin e KE, duke kërkuar që t'i sqarohet arsyeja përse është degraduar në pozitë, ndërsa F.K. si Shef i NJHKEK në Prizren, i është drejtuar N.S. si Shef të NJRHKEK në Prizren, duke i propozuar që paditësi S.B. të emërohet nga pozita e mbikëqyrësit në Ekipin A të NJHKEK në Prizren, në hetues pranë kësaj Njësie.

Përmes leximit të Vendimit me numër të referencës 07/1-01A/7721 të datës 18.11.2016 lëshuar nga Ministria e Punëve të Brendshme - Policia e Kosovës - Drejtoria e Përgjithshme e Policisë, Drejtoria e Personelit Prishtinë, gjykata ka vërtetuar se paditësi S.B. është emëruar në pozitën hetues i Ekipit B, në Njësinë për Hetimin e Krimeve Ekonomike dhe Korrupsionit në Prizren, në gradën rreshter, vendim i cili ishte efektiv nga data 21.11.2016.

Me leximin e Memorandumit zyrtar të datës 07.11.2016 lëshuar nga e paditura, gjykata ka vërtetuar se në vend të paditësit S.B. mbikëqyrës në Ekipin A të NJRHKEK në Prizren është caktuar L.S. ndërsa paditësi është caktuar në pozitën e hetuesit në Ekipin B të njësies së lartcekur.

Nga leximi i korrespondencës përmes rrugës elektronike të datës 17.11.2016 ora 14:43, vërtetohet se shefi i stafit të Drejtorit të Përgjithshëm të PK-së, M.B. ka njoftuar Drejtorin e Departamentit për Burime Njerëzore të PK-së, Agron Rukiqin se me aprovimin e Drejtorit të Përgjithshëm në NJHKEK në Prizren paditësi është caktuar në pozitën e hetuesit në Ekipin B të kësaj njësie.

Me leximin e korrespondencës përmes rrugës elektronike të datës 18.11.2016 ora 3:21 PM, është vërtetuar se paditësit gabimisht i është lëshuar vendimi për hetues në Ekipin B të NJRHKEK në Prizren, në vend të hetuesit në Ekipin A të NJRHKEK në Prizren.

Baza ligjore

Në bazë të Ligjit të Punës nr. 03/L-212, përcaktohet se: “*I punësuari sipas nevojës mund të sistemohet në punë nga një vend në një vend tjetër, tek i njëjti punëdhënës në pajtim me Kontratën e Punës, Aktin e Brendshëm të Punëdhënësit dhe Kontratën Kolektive*”. Më tutje,

sipas nenit 44 par. 2 të Ligjit për Policinë nr. 04/L-076, shprehimisht përcaktohet se “*Marrëdhënia e punës për personelin policor rregullohet me akt nënligjor*”. Ndërsa, sipas këtij akti nënligjor, përkatësisht nenit 32 par. 1 të Udhëzimit Administrativ nr. 07/2012 mbi Marrëdhënien e Punës në Policinë e Kosovës, është paraparë se: “*Personeli policor për shkak të nevojave operacionale të shërbimit, pa pëlqimin e tij/saj, mund të sistemohet për kohë të caktuar apo për kohë të pacaktuar prej një vendi në një vend tjetër të punës*”. Në par. 2 të këtij neni thuhet se: “*Në raste të gjendjes së jashtëzakonshme, punonjësi pa pëlqimin e tij mund të sistemohet për kohë të caktuar në vendin e punës me pozitë më të ulët se pozita të cilën e ka pasur*”. Tutje, në nenin 32 par. 3 të UA nr. 07/2012 parashihet se: “*Autoriteti vendimmarrës nga paragrafi 1 dhe 2 i këtij neni është Drejtori i Përgjithshëm i Policisë*”. Në par. 4 të nenit 32 theksohet se: “*Përveç sistemimit/transferit nga paragrafët paraprak i këtij neni, për shkak të nevojave operacionale të shërbimit, në nivelin lokal të organizimit të policisë Drejtorët e Drejtorive Rajonale janë kompetent për transferin e policëve dhe rreshterëve brenda drejtorisë së tyre përkatëse...*”.

Në vijim, sipas nenit 30 par. 1 të UA nr. 07/2012 parashihet që: “*Sistemimi dhe transferi i personelit policor, në vendet dhe detyrat e punës, duhet t’iu përshtaten nevojave operacionale dhe strukturës organizative të Policisë*”. Në par. 5 të nenit të lartcekur përcaktohet se: “*Personelit të Policisë i garantohet mbrojtja kundër çfarëdo largimi apo transferimi të paarsyeshëm ose të panevojshëm nga vendi i tyre i punës*”. Kështu, neni 78 par. 1 i Ligjit të Punës parasheh se: “*I punësuar i cili vlerëson se punëdhënësi ka shkelur të drejtën e marrëdhënies së punës, mund të paraqesë kërkesë te punëdhënësi apo organi përkatës i punëdhënësit nëse ekziston, për realizimin e të drejtave të shkelura*”. Ndërsa, sipas par. 2 të këtij neni thuhet se: “*Punëdhënësi është i obliguar për të vendosur sipas kërkesës së të punësuarit, në afatin brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga data e pranimit të kërkesës*”. Në vazhdim, si mënyrë e mbrojtjes së të drejtave të të punësuarve, është paraparë edhe mbrojtja e të punësuarit përmes gjykatës, ku në nenin 79 të Ligjit të Punës parashihet se: “*Çdo i punësuar i cili nuk është i kënaqur me vendimin me të cilin mendon se i janë shkelur të drejtat e tij, ose nuk merr përgjigje brenda afatit nga neni 78 paragrafi 2 të këtij ligji, në afatin vijues prej tridhjetë (30) ditësh, mund të inicioj kontest pune në Gjykatën Kompetente*”.

Vlerësimi përfundimtar i gjykatës

Nga provat e faktet e lartcekura, nuk është kontestuese as mes palëve ndërgjyqëse se paditësi ka gradën e rreshterit dhe në kohën e parashtrimit të padisë ka pasur pozitën hetues në Ekipin A të NJHKEK në Prizren. Po ashtu, kontestuese ndërmjet palëve nuk ishte edhe fakti se paditësi ka qenë në pozitën mbikëqyrës në Ekipin A të NJHKEK në Prizren, ndërsa më vonë fillimisht është caktuar në pozitën hetues në Ekipin B të NJHKEK në Prizren, pastaj është caktuar hetues në Ekipin A të së njëjtës njësi. Mirëpo, kontestuese në mes palëve është fakti nëse vendimet me anë të së cilëve paditësit i është ndërruar vendi i punës, janë të ligjshme apo jo, lidhur me respektimin e procedurës për ndërrimin e vendit të punës së punëtorëve në Policinë e Kosovës.

Në vazhdim, në bazë të provave të administruara në këtë procedurë dhe bazës ligjore të cekur si më lartë, gjykata erdhi në përfundim se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar dhe se e njëjta edhe duhet të aprovohet në tërësi sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi. Kjo ngase në bazë të provave të administruara në këtë procedurë, gjendjes faktike të vërtetuar mbi bazën e provave të administruara në këtë procedurë, si dhe bindjes së lirë të gjykatës, është provuar se e paditura, me vendimet e saja të cilat janë anuluar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, ka vepruar në mënyrë të kundërligjshme kur ka vendosur që t’ia ndërroj vendin e punës paditësit,

respektivisht vendimi nuk është marrë nga ana e personit të autorizuar dhe kompetent të përcaktuar sipas dispozitës së lartcekur ligjore, neni 32 të UA nr. 07/2012.

Në të vërtetë, nga provat e administruara është vërtetuar se gjatë marrjes së vendimeve kontestuese nuk është respektuar procedura për ndërrimin e vendit të punës apo pozitës së një nëpunësi në kuadër të Policisë së Kosovës dhe se për këtë arsye vendimet në fjalë i bënë të kundërligjshme. Kështu, sipas dispozitave ligjore të theksuara në kuadër të bazës juridike, më konkretisht sipas nenit 32 par. 3 të Udhëzimit Administrativ nr. 07/2012 mbi Marrëdhënien e Punës në Policinë e Kosovës, shprehimisht dhe në mënyrë konkrete është përcaktuar se në rastin e sistemimit apo caktimit në vend tjetër të punës, sikurse është rasti lidhur me këtë çështje juridike kontestimore, autoritet vendimmarrës për një gjë të tillë është Drejtori i Përgjithshëm i Policisë. Në këtë drejtim, si në vendimin nr. 07|1-01A|7772 të datës 22.11.2016 për caktimin e paditësit në pozitën hetues i Ekipit A në NJRHKEK në Prizren dhe vendimin nr. 07|1-01A|7721 të datës 18.11.2016 për caktimin e paditësit në pozitën hetues i Ekipit B në NJRHKEK në Prizren, nuk kemi respektim të procedurës për caktimin e paditësit në pozitë të hetuesit, përkatësisht vendimi është lëshuar apo nxjerrë nga Drejtori i Drejtorisë së Personelit në PK, duke theksuar se një vendim i tillë është bërë me aprovimin e Drejtorit të Përgjithshëm. Sipas dispozitës ligjore të cekur më lartë, për punonjësit me gradën rreshter vetëm informohet Drejtori i Drejtorisë së Personelit, por se i njëjti nuk është kompetent për marrjen e vendimit për sistematizim. Në këtë mënyrë, një mënyrë e tillë e vendosjes është në kundërshtim me nenin 32 par. 3 të UA nr. 07/2012, sepse vendimet e lartcekura do duhej të merreshin nga Drejtori i Përgjithshëm.

Një konstatim i tillë gjen mbështetje edhe në nenin 32 par. 4 të UA nr. 07/2012, në të cilën dispozitë ligjore përcaktohet se caktimi apo transferi i rreshterëve, gradë të cilën e ka edhe paditësi, bëhet sipas vendimit të Drejtorit të Drejtorisë përkatëse në të cilën ndodhen ata zyrtarë policor apo rreshter, brenda Drejtorisë së tyre përkatëse. Mirëpo në rastin për të cilin po zhvillohet ky kontest, nuk është respektuar asnjëra nga procedurat apo rrugët për caktimin apo transferimin e paditësit nga pozita e mbikëqyrësit në Ekipin A të NJRHKEK në Prizren, në pozitën e hetuesit në Ekipin B, përkatësisht Ekipin A në NJRHKEK në Prizren, për çka vendimet e tilla gjykata i vlerësoi të kundërligjshme dhe të njëjtit i anuloi dhe i la pa fuqi juridike, sikurse në pikën nën I të dispozitivit të aktgjykimit.

Në këtë drejtim, sipas mendimit të kësaj gjykate në rastin konkret kemi të bëjmë me zbatim të gabuar të së drejtës materiale, pasi që paditësi është me gradën e rreshterit dhe se sistemimi apo caktimi i zyrtarit policor nga kjo pozitë në një pozitë tjetër, është e rregulluar me nenin 32 par. 3 dhe 4 të UA nr. 07/2012, të cilin fakt apo rrethanë e paditura nuk e ka marrë parasysh me marrjen e vendimeve të kontestuar apo edhe me rastin e vendosjes së ankesave që paditësi i ka parashtruar pranë Drejtorisë së Personelit në PK, përkatësisht Komisionit të Ankesave në PK. Andaj, duke i marrë për bazë të gjitha këto fakte, gjykata vendosi sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi, përkatësisht aprovoi kërkesëpadinë e paditësit si tërësisht të bazuar, njëherë detyroi palën e paditur që të kthejë në punë dhe detyrat e punës së mbikëqyrësit të Ekipit A në NJRHKEK në Prizren sikurse në pikën nën II të dispozitivit të aktgjykimit, duke lënë në fuqi vendimin me numrin e referencës 07/1-01A/0422 të datës 20.01.2015.

Gjithashtu, gjykata gjeti se në veprimet e të paditurës, ka shkelje në drejtim të vërtetimit jo të plotë dhe të gabuar të gjendjes faktike për rastin i cili është objekt i këtij kontesti, shkeljeve të dispozitave ligjore të lartcituara, si dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, për arsye dhe shkaqet e elaboruara më lartë, për çka edhe vendimet e atakuar të të paditurës, u anuluan në tërësi si të kundërligjshme. Andaj, mbi bazën e të gjitha provave të administruara

në këtë procedurë, gjendjes faktike të vërtetuar mbi bazën e këtyre provave, si dhe bindjes së lirë të gjykatës të formuar mbi bazën e kësaj gjendje faktike të vërtetuar, në pajtim me nenin 8 të LPK-së, përfundimisht gjykata gjeti se kërkesëpadia e paditësit është tërësisht e bazuar dhe se e njëjta duhet të aprovet sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Vlen të ceket se me nenin 7 par. 1 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), është paraparë se: **“Palët kanë për detyrë që të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla”**, andaj përgjatë tërë zhvillimit të procedurës, gjykata është e lidhur vetëm me propozimet dhe provat të cilat i propozojnë palët ndërgjyqëse, siç edhe është vepruar në këtë rast.

Në vazhdim, gjykata vlerësoi pretendimet e palës së paditur se sistemi apo caktimi i paditësit në pozitën hetues në Ekipin B, përkatësisht Ekipin A të NJRHKEK në Prizren është bërë në përputhje me dispozitat ligjore, mirëpo erdhi në përfundim që një pretendim i tillë është tërësisht i pabazuar dhe nuk ka asnjë mbështetje ligjore, sepse në përshkrimin dhe elaborimin e nenit 32 par. 3 dhe 4 të UA nr. 07/2012, rezulton se e paditura me rastin e sistemimit apo caktimit të paditësit nga pozita mbikëqyrës në Ekipin A të NJRHKEK në Prizren, në pozitën hetues në Ekipin B, përkatësisht Ekipin A të NJRHKEK në Prizren, është realizuar duke mos respektuar dispozitat ligjore në fjalë.

Gjykata ka vlerësuar edhe theksimet dhe provat e tjera të palëve ndërgjyqëse, por ka gjetur se të njëjtat janë pa ndikim në nxjerrjen e këtij aktgjykimi.

Në lidhje me shpenzimet procedurale gjykata vendosi sikurse në pikën nën III të dispozitivit të aktgjykimit, duke u bazuar në nenin 452 par. 1 të LPK-së dhe atë për shpenzimet si në vijim: për përpilimin e padisë shumë prej 104 euro, në emër të taksës gjyqësore shumë prej 40.00 euro, për përpilimin e revizionit shumë prej 160.00 euro, për taksën për revizion shumë prej 40.00 euro, për 10 seanca gjyqësore, secila prej tyre e llogaritur nga 135,00 euro, respektivisht shumë e tërësishme të shpenzimeve procedurale në lartësi prej 1,694 euro.

Nga të lartcekurat më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, konform nenit 143 par. 1 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
Departamenti i Përgjithshëm
C.nr.4613/2023, më datë 21.02.2024

Gjyqtarja
Edije Sezairi

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, pas ditës së pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate Themelore.